

**Universiteti i Gjilanit, Fakulteti Ekonomik, Drejtimi: Banka, Financa dhe Kontabilitet
Tregjet dhe Institucionet Financiare, Dr. Gëzim Tosuni, Test 1, dhjetor 2017 (A)**

Zgj. e testit:

1.
 - a) Obligacionet, aksionet e zakonshme, aksionet preferenciale, kontratat fjuqers dhe forvard.
 - b) Letrat me vlerë janë aktiv i paprekshëm ndërsa toka, ndërtesat dhe pajisjet janë aktiv i prekshëm.
 - c) Tregu financiar është vend i organizuar në të cilin tregtohet me forma të diferencuara të aktivitetit financiar.

2.
 - a) Shtimi ekonomik pa inflacion dhe niveli i lartë i punësimit janë objektivat e politikës monetare. Ndërsa rritja e të hyrave nga tatimet dhe taksat ka të bëjë me politikën fiskale.
 - b) Bruto produkti vendor paraqet vlerën e tregut të të gjitha produkteve dhe shërbimeve të prodhuara gjatë një periudhe të caktuar kohore. Të hyrat kombëtare paraqesin shumën e të gjitha llojeve të pagesave, siç janë: pagat javore, mujore, dividendët, profitet nga ndërmarrjet jokorporative, intereset dhe qiratë.

3.
 - a) Letrat me vlerë të datës në fillim të janarit të vitit 2008, afati i maturimit i të cilave është i shkurtër, janë të tregtuara në tregun e parasë. Ndërsa ato me afat të gjatë në tregun e kapitalit.
 - c) Përparësitë e tregut të kapitalit: shtimi, pozita, fleksibiliteti, shtija e pronës.
Të metat e tregut të kapitalit: ekspozimi ndaj publikut, presioni i investitorëve, shkrirja, dhënia e informacioneve të besueshme.
 - d) Meqë korporata "Apple" ka këmbyer valuta të huaja me atë të vendit, atëherë ka përdorur kursin indirekt të këmbimit.
 - e) II) metoda e përpjekjeve maksimale, pasi bankieret nuk marrin përsipër rrezikun e plotë.

4.
 - a) Obligacionet e përhershme: me datë 5 janar emetoj 10.000 obligacione të cilat nuk kanë afat maturimi dhe nuk riblehen.
Obligacionet konvertibile: 15.000 obligacione të cilat blerësit e tyre mund t'i këmbëjnë me letra të tjera me vlerë.
Obligacionet e denominuara në dy valuta: Me datë 15 prill korporata do të emetoj obligacione të cilat normat e interesit janë të shprehura në funta ndërsa kryegjësja në euro.
Euroobligacione: Me datë 5 gusht do të emetoj obligacione të shprehura në valuta të ndryshe.
Tregu primar: Të gjitha obligacionet nga data 5 janar deri me datë 5 gusht janë emetuar për herë të parë në treg.
 - b) Përparësitë janë: shpenzimet e borxhit janë të limituara, shpenzimet e borxhit janë dukshme me të ultë se ato të kapitalit, ruhet kontrolli ndaj kompanisë, pagesat e kamatës dhe kryegjësë paraqiten si shpenzime afariste në bilancin e suksesit dhe lirohen nga pagesa e tatimeve.
Të metat: borxhi paraqet obligim fiks, ka një limit deri ku firma mund të financohet me borxh, borxhi bart një rrezik për vet ndërmarrjen.
 - c) Tek ky lloj i obligacioneve, pronaret nuk janë të evidentuar në regjistrat dhe librat e emitentëve, prandaj emërohen si obligacione në prurësin.
 - d) Dallimet janë:
 - Është forma më e lirë e financimit, përmes borxhit sesa përmes aksioneve preferenciale.
 - Kanë përparësi në pagesën e dividendës,
 - Në rast falimentimi së pari paguhen obligacion mbajtësit pastaj aksionet preferenciale dhe krejt në fund aksionet e zakonshme,
 - Aksionet preferenciale shumë rrallë kanë të drejtë vote,
 - Tek aksionet preferenciale norma e dividendës nuk është fikse.

5.

- a. Aksionet preferenciale: me 20 janar 2018 do të emetohen 10.000 aksione tek të cilat poseduesit e tyre marrin dividendin fikse
Aksionet e garantuara: Me datë 3.02, do të emetohen 12.000 aksione që do të jenë të garantuar nga një institucion financiar përkatës
Aksionet preferenciale kumulative: ndërsa me datë 3.03. do të emetoj 3000 aksione për të cilat grumbullohet dividenda
Aksionet preferenciale jokumulative: 1000 për të cilat nuk akumulohen dividendët
Aksionet e autorizuara: të gjitha aksionet nga data 20 janar deri me datë 3 mars paraqesin numrin maksimal të aksioneve që mund të emetoj kjo korporata.
Aksionet e emetuara: Aksionet e viti të kaluar të korporatës tashme të emetuara janë të tregtuara në bursat me të njohura dhe numri i tyre është më i madh se 500.000.
- b. Çmimi për një aksion është 20.
- c. Kapitali aksionar i korporatës është 2000.000 €/20€ çmimi për një aksion= 100.000 aksione.
- d. E drejta e votës, e drejta në dividend, e drejta në riblerje, e drejta në qasje në librat afariste, e drejta në rast bankroti, e drejta në transferin e aksioneve.

6.

- a. Me rastin e votimit sipas sistemit kumulativ korporata kishte: II) 9000 vota (3 menaxherë x 3000 aksione)
- b. Kjo do të thotë se në çdo 5 aksione të vjetra, ai fiton të drejtën që të blejë një aksion të ri.
- c. $n_a = ((6 \times 20000 \text{ aksione}) / 13) + 1 = 9232 \text{ aksione}$
- d. Këtë sistem të votimit që u shfrytëzua e njohim si sistem përmes autorizimit.
- e. $n_m = (7000 \text{ aksione} - 1) \times (12 + 1) / 20\,000 = 5.$

Zgj. e testit:

1.
 - a) Obligacionet, aksionet e zakonshme, aksionet preferenciale, kontratat fjuqers dhe forward.
 - b) Letrat me vlerë janë aktiv i paprekshëm ndërsa toka, ndërtesat dhe pajisjet janë aktiv i prekshëm.
 - c) Kursi i këmbimit paraqet shumën e njësisë së valutës që mund të këmbëhet për njësi të valutës tjetër, respektivisht si çmimi i një njësi të valutës i shprehur në valutën tjetër.

2.
 - a. Shtimi ekonomik pa inflacion dhe niveli i lartë i punësimit janë objektivat e politikës monetare. Ndërsa rritja e të hyrave nga tatimet dhe taksat ka të bëjë me politikën fiskale.
 - b. Funkzioni i parë i tregut të kapitalit është emetimi i letrave me vlerë në tregun primar. Ndërsa funksioni i dytë ushtrohet në tregjet sekondare të letrave me vlerë, të cilat kane qenë të emetuara që më parë.

3.
 - a) Letrat me vlerë të datës: në fillim të janarit të vitit 2008, afati i maturimit i të cilave është i shkurtër, janë të tregtuara në tregun e parasë. Ndërsa ato me afat të gjatë në tregun e kapitalit.
 - b) Përparësitë e tregut të kapitalit: shtimi, pozita, fleksibiliteti, shtija e pronës.
Të metat e tregut të kapitalit: ekspozimi ndaj publikut, presioni i investitorëve, shkrirja, dhënia e informacioneve të besueshme.
 - c) Meqë korporata "Apple" ka këmbyer valuta të huaja me atë të vendit, atëherë ka përdorur kursin indirekt të këmbimit.
 - d) I) metoda e zotimit të firmës, meqë bankierët marrin përsipër rrezikun e plotë.

4.
 - a) Obligacionet e përhershme: me datë 5 janar emetoj 10.000 obligacione të cilat nuk kanë afat maturimi dhe nuk riblehen.
Obligacionet konvertibile: 15.000 obligacione të cilat blerësit e tyre mund t'i këmbëjnë me letra të tjera me vlerë.
Obligacionet e denominuara ne dy valuta: Me datë 15 prill korporata do të emetoj obligacione të cilat normat e interesit janë të shprehura në funta ndërsa kryegjëja në euro.
Euroobligacione: Me datë 5 gusht do të emetoj obligacione të shprehura në valuta të ndryshe.
Tregu primar: Të gjitha obligacionet nga data 5 janar deri me datë 5 gusht janë emetuar për herë të parë në treg.
 - b) Përparësitë janë: shpenzimet e borxhit janë të limituara, shpenzimet e borxhit janë dukshëm më të ultë se ato të kapitalit, ruhet kontrolli ndaj kompanisë, pagesat e kamatës dhe kryegjësë paraqiten si shpenzime afariste në bilanc të suksesit dhe lirohen nga pagesa e tatimeve.
Të metat: borxhi paraqet obligim fiks, ka një limit deri ku firma mund të financohet me borxh, borxhi bart një rrezik për vet ndërmarrjen.
 - c) Tregjet termine u lindën si rezultat i përpjekjeve të prodhueseve të mallrave dhe shërbimeve për t'u ikur jo stabilitetit të çmimeve në të ardhmen. Produktet që tregtohen në to janë: pambuku, kakao, sheqeri, etj
 - d) Dallimi mes tyre qëndron në atë se në rastin e kontratave fjuqers, që të dyja palët, blerësi dhe shitësi, janë të obliguara që të kryejnë detyrimet, ndërsa në rastin e kontratave opSION, blerësi i opSIONIT ka të drejtë, por jo edhe obligim që të bëjë biznes.

5.

- a. Aksionet preferenciale: me 20 janar 2018 do të emetohen 10.000 aksione tek të cilat poseduesit e tyre marrin dividendin fikse.
Aksionet e garantuara: Me datë 3.02, do të emetohen 12.000 aksione që do të jenë të garantuar nga një institucion financiar përkatës.
Aksionet preferenciale kumulative: ndërsa me datë 3.03. do të emetoj 3000 aksione për të cilat grumbullohet dividenda.
Aksionet preferenciale jökumulative: 1000 për të cilat nuk akumulohen dividendët
Aksionet e autorizuara: të gjitha aksionet nga data 20 janar deri me datë 3 mars paraqesin numrin maksimal të aksioneve që mund të emetoj kjo korporata.
Aksionet e emetuara: Aksionet e viti të kaluar të korporatës tashme të emetuara janë të tregtuara në bursat me të njohura dhe numri i tyre është më i madh se 500.000.
- b. Çmimi për një aksion është 10€.
Kapitali aksionar i korporatës është 2000.000 €/
10 € çmimi për një aksion= 200.000 aksione.
- c. Vlera që kanë merret si e ardhur, respektivisht si fitim,
Koha e pagesës së kryegjësë,
Rreziku,
Tregtueshmëria e tyre.
- d. Zvogëlimi i rolit të institucioneve qeverisëse, kombinimi i rregullimit ligjor me vete rregullim, fleksibilitet më i madh i tregjeve financiare për firma të jashtme.

6.

- a. Me rastin e votimit sipas *sistemit* kumulativ korporata kishte: I) 3000 vota
(3 menaxhere x 1000 aksione)
- b. Kjo do të thotë se në çdo 6 aksione të vjetra, ai fiton të drejtën që të blejë një aksion të ri.
- c. $na = ((7 \times 20000 \text{ aksione}) / 13) + 1 = 10\,770 \text{ aksione}$
- d. Këtë sistem të votimit që u shfrytëzua e njohim si sistem përmes autorizimit.
- e. $nm = (7000 \text{ aksione} - 1) \times (10 + 1) / 20\,000 = 4.$